



**Programet e studimit në Fakultetin Ekonomik të  
Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren për vitin  
akademik 2021/2022**

# I. FAKULTETI EKONOMIK

Në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, vepron Fakulteti Ekonomik i cili u themelua në vitin 2010. Ideja fillestare për themelimin të Fakultetit Ekonomik ka lindur si nevojë imediate e kërkesës së tregut për specialistë të fushës së menaxhimit, administrimit të biznesit, financave të kompanive dhe të kontabilitetit dhe auditimit në rajonin e Prizrenit. Për më tepër, Fakulteti Ekonomik i kontribuon komunitetit të biznesit nëpërmjet përgaditjes së kuadrove për ndërkombëtarizimin e kompanive rajonale dhe vendore nëpërmjet programeve studimore të administrimit të biznesit, menaxhmentit ndërkombëtar dhe kontabilitetit dhe auditimit.

Fakulteti Ekonomik me konkretisht ofron këto programe të studimit:

Programet e studimit në nivelin Bachelor janë:

- Administrim Biznesi dhe
- Menaxhment Ndërkombëtar.

Programet e studimit në nivelin Master janë:

- Administrim Biznesi dhe
- Kontabilitet dhe Auditim.

Zhvillimi i këtyre programeve është i lidhur ngushtë me nevojat e tregut të punës dhe të zhvillimit të biznesit jo vetëm në rajonin e Prizrenit por edhe më gjërë. Numri i nxënësve të cilët e mbarojnë shkollën e mesme nga ky rajon, kanë mundësi reale për të përzgjedhë njërin nga këto programe për studime themelore dhe më pas të vazhdojnë edhe me studimet në nivelin mastër.

Duke pas parasysh historikun e kërkesës për t’u regjistruar në këto programe, që vazhdimisht ka qenë në rritje, ekziston arsyeshmëria e plotë e zhvillimit të këtyre programeve në nivelin Bachelor dhe Mastër të studimeve në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

## 1.1. Administrim Biznesi (BSc.)

Programi i studimeve Bachelor në “Administrim Biznesi”, është program interdisciplinar i hartuar me kujdes për studentët të cilët janë të interesuar për fushën e administrimit të biznesit.

Misioni i programit Administrim Biznesi (AB) është që të përgadisë studentë me aftësi praktike menaxhuese në kontekstin e ndërmarrjeve globale duke arritur shkathtësi dhe kapacitete të mjaftueshme profesionale për karrierë të liderit produktiv në sistemin ekonomik të tregjeve të lira dhe të ndërmarrjeve private, i bazuar në frymën e ndërmarrësisë konkurruese.

Ky program studimor poashtu ka për mision të ofrojë edukim cilësor dhe të avancojë njohuritë dhe shkathtësitë praktike të studentëve në konkurrencën biznesore dhe në menaxhimin e bizneseve, jo vetëm në tregun e mbrendshëm por edhe në atë ndërkombëtar. E rëndësishme për këtë program të studimit është që të rrisë nivelin e hulumtimit në fushën e biznesit dhe studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kreativë, inovativë dhe komunikues në zgjidhjen e problemeve biznesore dhe të vendimmarjes duke u bazuar në përdorimin e

një literaturë të gjërë analitike, hulumtuese dhe praktike që të prodhojë lider në fushën e Ekonomisë.

Një nivel të tillë të njohurive e garanton vet Kurikula e hartuar e këtij programi në të cilën përfshihen lëndë nga fusha zhvillimit të Ndërmarrësisë, pastaj të Menaxhimit modern të Biznesit, të Marketingut, të Makroekonomisë, të Mikroekonomisë, të Financave të Korporatave, të Kontabilitetit, të Biznesit Ndërkombëtar etj, (shih kurikulën e programit).

Programi i studimeve Bachelor në "Administrim Biznesi" është program trevjeçar i studimeve dhe përfshinë 6 semestra me gjithsej 180 ECTS. Ky program ju mundëson studentëve të arrijnë një nivel të duhur të njohurive bazike nga fusha e Administrimit të Biznesit, të njohin kompleksitetin e organizatave biznesore vendore dhe ndërkombëtare, marrëdhëniet e ndërvarura në mes bizneseve dhe legjislativioneve vendore dhe ndërkombëtare mbi të cilat ato e zhvillojnë biznesin si dhe vështirësitë në administrimin e biznesit. Ky program studentëve do të ju ofroj njohuri të mjaftueshme për menaxhim bashkohor të biznesit në një ambient konkurrues biznesor. Duke studjuar këtë program studentët do të jenë në gjendje të studiojnë në tërësi parimet e lëndëve të biznesit duke përfshirë: Bazat e Menaxhimit, Kontabilitetin Financiar, Financat e korporatave, Bazat e marketingut, Ndërmarrësinë, Makroekonominë, Mikroekonominë, Komunikimin në Biznes, Qeverisja korporative, Marrja e vendimeve Biznesore, etj.

Ky program ju ofron studentëve një përvojë praktike që ata ti përgatit për hyrje të menjëhershme në pozita të ndryshme, duke përfshirë edhe pozitat menaxhuese në sektorët e ndryshëm të biznesit. Kjo biografi e punës praktike do të implementohet nga programet praktike të konceptuara në bashkëpunim me subjektet biznesore vendore dhe ndërkombëtare. Ne tani e kemi themeluar me Raffeisen Bank në Kosovë një program për praktikë profesionale, dhe me Bankën Ekonomike të Kosovës, ku studentat tanë e kryejnë praktikën në kohëzgjatje nga një deri në tre muaj. Gjithashtu kemi marëveshje të shkruar me Aleancën Kosovare të Bizneseve nëpërmjet të cilës për çdo vit i sistemojmë të gjithë studentat e vitit të tretë nëpër biznese, institucione financiare, kuvende komunale dhe ndërmarrje publike për ta kryer pjesën praktike në kohëzgjatje prej 60 orë.

Fakulteti Ekonomik ka nënshkruar marëveshje bashkëpunimi edhe me Odën e Tregtisë dhe Industrisë të Edirnes - Turqi, ku çdo vit studentat e vitit të tretë (përparësi do të kenë ata që e njohin gjuhën Turke) do të mund ta kryejnë pjesën praktike.

Objektivat e këtij programi janë që:

- studentëve të ju mundësoj të përvetsojnë njohuri teorike dhe praktike të qëndrueshme për organizatat biznesore.
- Studentët të zhvillojnë aftësitë analitike për të kryer hulumtime dhe për të inkurajuar ide inovative.
- studentët të jenë të aftë dhe të shkathët të menaxhojnë biznese të ndryshme.
- Studentët të jenë në gjendje të zhvillojnë përshtatshmëri dhe fleksibilitet të qasjes dhe aftësisë për të inicuar dhe përgjigjur pozitivisht dhe në mënyrë të duhur ndryshimeve.
- t'i përgatisë studentët për karrierë në biznes ose për fushat që lidhen me biznesin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për të kontribuar në shoqëri.
- t'i rrisë aftësitë e të mësuarit të studentit gjatë gjithë jetës, aftësitë komunikuese dhe zhvillimin personal.
- Studentët të jenë në gjendje t'i qasen drejtë zgjidhjes së problemeve me të cilat mund të ballafaqohen në garën biznesore.
- Në fushëverpimin e këtij programi, studentët do të përfitojnë kompetenca shoqërore dhe ndërkulturore.

- Studentët të përgaditen dhe të menaxhojnë suksesshëm me ndryshimet në korporat, si dhe të zhvillojnë dhe të praktikojnë nevojën e zbatimit të etikës biznesore dhe të përgjegjësisë sociale.

Gjithashtu janë të parapara edhe vizita studimore për studentë të cilët do të kenë mundësi të përcjellin nga afër rrjedhat e menaxhimit, qeverisjes, financave etj, nëpër korporata ndërkombëtare dhe vendore. Janë nënshkruar Marëveshje me Odën Ekonomike të Turqisë, por edhe me Asociacione të bizneseve nga vendet Perëndimore dhe Odën Ekonomike të Kosovës.

Pas përfundimit të studimeve në programin “Administrim Biznesi”, studentët:

- do të kenë nivel më të lartë të njohurive si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik,
- do të kenë të zhvilluara aftësitë praktike dhe teorike për të analizuar dhe zgjidhë problemet si dhe për të aplikuar njohuritë e tyre në praktikë nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit dhe të raportimit;
- do të jenë në gjendje për të marrë vendime dhe për të administruar biznesin në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi.
- do të jenë të përgaditur për të hyrë në tregun e mbrendshëm dhe të jashtëm të punës;
- do të jenë në gjendje për të vepruar në ambient konkurues biznesor;

## Kurikula

### Bachelor Shkencor në Administrim Biznesi - BSc

#### Viti I - Semester I and II, viti akademik 2021/2022

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Matematika Afariste	2	3	6
2	O	Kontabilitet Financiar – I -	2	3	6
3	O	Mikroekonomi	2	2	5
4	O	Ndërmarrësi	2	2	5
5	O	Bazat e Marketingut	2	2	4
6	O	Anglishtja Afariste – I -	2	2	4
<b>Σ</b>					<b>30</b>

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Kontabiliteti Financiar – II -	2	3	6
2	O	Makroekonomi	2	2	5
3	O	Statistikë	2	3	5
4	O	Biznesi Ndërkombëtar	2	2	5
5	O	Bazat e Menaxhimit	2	2	5
6.1.	Z	Anglishtja Afariste -II-	2	2	4
6.2.	Z	Shkrimi Akademik	2	2	4
<b>Σ</b>					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin njëren nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

#### Viti II - Semesteri III dhe IV

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Financat e Korporatave	3	2	6
2	O	E- Marketingu	2	2	5
3	O	Marrja e vendimeve biznesore	2	2	5
4	O	Informatika në Biznes	2	2	5
5	O	Organizimi i ndërmarrjeve	2	2	5
6.1.	Z	Komunikimi në Biznes	2	2	4
6.2.	Z	Gjuhë Gjermane	2	2	4
<b>Σ</b>					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin një të një nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	2	2	6
2	O	Kërkimet e tregut	2	2	5
3	O	Shkathtësitë Negociuese - Leadership	2	2	5
4	O	Menaxhimi i ndryshimeve	2	2	5
5	O	Menaxhimi i Projekteve	2	2	5
6.1.	Z	Etika në Biznes	2	2	4
6.2.	Z	Gjuhë Turke	2	2	4
<b>Σ</b>					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin një të një nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

### Viti III - Semesteri V dhe VI

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Raportimi Financiar I	2	2	6
2	O	Auditimi	3	1	6
3	O	Kontabiliteti i Tatimeve	2	2	6
4	O	Sistemi Informativ i Kontabilitetit	2	2	6
5	O	Vizitë Studimore			6
<b>Σ</b>					<b>30</b>

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Analiza Financiare	1	2	4
2	O	Kontabiliteti Menaxherial	1	2	4
3	O	Raportimi Financiar II	1	2	4
4	O	Qeverisja Korporative	3	0	3
5	O	Praktika			3
5	O O	PUNIMI I DIPLOMËS			12
<b>Σ</b>					<b>30</b>

#### 1.2. Menaxhmenti Ndërkombëtar (BSc.)

Misioni i programit Menaxhment Ndërkombëtar është të përgatisë studentët me aftësi praktike menaxhuese në kontekstin e ndërmarrjeve globale, duke përvetësuar shkathtësi dhe kapacitete intelektuale të mjaftueshme, për karrierë ndërkombëtare në biznes, si dhe një lidhshmëri produktiv në sistemin ekonomik bazuar në tregun e lirë dhe ndërmarrjeve private, i bazuar në frymën e menaxhimit të një ndërmarrësie konkurruese. Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren i shërben rajonit të Prizrenit dhe vendit për zhvillimin dhe edukimin e studentëve për të qenë të aftë të përfshihen në tregun e punës në Kosovë dhe më gjërë. Universiteti synon që nëpërmjet programeve të lartpërmendura të zhvilloj shkathtësitë aplikative të studentëve me kompetencë, me qëllim që të jenë të barabartë dhe të përgaditur me njohuri dhe shkathtësi për zbatimin praktik të tyre.

Qëllimi në kuadër të Programit Menaxhment Ndërkombëtar është ndërtimi, zhvillimi dhe implementimi i një orientimi praktik të njohurive nga fusha e menaxhmentit, e posaqërisht të menaxhimit në biznesin ndërkombëtar. Gjithashtu Programi Menaxhment Ndërkombëtar ofron mundësi që studentët tanë të diplomuar të kenë njohuri të mjaftueshme për tregun global dhe sjelljet në të. Menaxhimi Ndërkombëtar si program në BA përfshinë lëndë nga fusha e menaxhmentit, Menaxhmentit Ndërkombëtar, Statistika, Biznesi dhe e Drejta biznesore Ndërkombëtare, Marketingu, E-marketingu, Kontabiliteti, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Ligjet e kompanive, Qeverisja Korporative dhe Komunikimi Ndërkulturorë dhe Analiza kuantitative në biznes, etj.

Qëllim tjetër i këtij programi është që studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kreativë, inovativë dhe komunikues në zgjidhjen e problemeve biznesore dhe të vendimarrjes duke u bazuar në përdorimin e një literature të gjërë analitike, hulumtuese dhe praktike.

Programi i studimeve ”Menaxhment Ndërkombëtar” është program trevjeçar i studimeve dhe përfshinë 6 semestra me gjithsej 180 ECTS. Qëllimi i programit është arritja e një niveli të kualifikuar të njohurive bazike nga fusha e menaxhmentit dhe biznesit ndërkombëtar. Ky program ju mundëson studentëve të njohin kompleksitetin e organizatave biznesore vendore dhe ndërkombëtare, marrëdhëniet e ndërvarura në mes bizneseve dhe legjislativioneve vendore dhe ndërkombëtare mbi të cilat ato e zhvillojnë biznesin si dhe vështirësitë në menaxhimin e biznesit. Ky program studentëve do të ju ofroj njohuri të mjaftueshme për menaxhimin bashkëkohor të biznesit në një ambient biznesor konkurrues.

Poashtu, një nga qëllimet tjera të këtij programi është që t’u ofrojë studentëve një përvojë praktike që ti përgatisë ata për të hyrë në pozita të ndryshme, duke përfshirë edhe pozitat menaxhuese në sektorët e ndryshëm të biznesit vendor por edhe të atij ndërkombëtar. Kjo biografi e punës praktike do të implementohet nga programet praktike të konceptuara në bashkëpunim me subjektet biznesore vendore dhe ndërkombëtare ku studentët do të mesojnë edhe kulturën e punës dhe sjelljet e një menaxheri në organizatë.

Objektivat e programit të kualifikimit janë:

- Programi do t’ju mundësoj studentëve që të përvetësojnë njohuri teorike dhe praktike të qëndrueshme për sjelljet, aktivitetet biznesore vendore dhe ndërkombëtare.
- Nëpërmjet programit të studimit Menaxhment Ndërkombëtar studentët do të jenë të aftë të zhvillojnë shkathtësi analitike dhe të reflektojnë në çështjet biznesore në tregjet globale.
- Studentët do të jenë në gjendje të zhvillojnë përshtatshmëri dhe fleksibilitet të qasjes dhe aftësisë për të inicuar dhe përgjigjur pozitivisht dhe në mënyrë të duhur ndryshimeve.
- Menaxhmenti Ndërkombëtar si program do t’i përgatisë studentët për karrierë në biznes, menaxhim efikas ose fushat që lidhen me menaxhimin dhe lidhshmërinë e tyre për të kontribuar në shoqërinë tonë dhe menaxhimin global.

- Nëpërmjet këtij programi synohet rritja e aftësive të studentëve për sa i përket, aftësive komunikuese, njohurive mbi globalizimin dhe zhvillimin si një menaxher ndërkombëtarë.
- Studentët do të jenë në gjendje t'i zbatojnë dijet e fituara për zgjidhjen e problemeve në mënyrë shkencore dhe pa paragjykime.
- Nga programi i Menaxhmentit Ndërkombëtar, studentët do të përfitojnë kompetenca shoqërore dhe ndërkulturore.
- Aspekti etik është gjithashtu i rëndësishëm dhe studentët do të jenë të aftë të perceptojnë sjelljet dhe normat etike, dhe ti zbatojnë në praktikë.

## Kurikula

### Bachelor Shkencor në Menaxhment Ndërkombëtar - BSc

#### Viti I - Semester I and II, viti akademik 2021/2022

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Matematika Afariste	2	3	6
2	O	Mikroekonomi	2	2	5
3	O	Statistika	3	2	5
4	O	Bazat e Menaxhimit Ndërkombëtar	3	2	5
5	O	Menaxhmenti Komunikues Ndërkulturor	2	2	4
6	O	Anglishtja Afariste – I -	2	2	5
					<b>30</b>

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Kontabilitet	3	2	6
2	O	Bazat e Financës	3	2	5
3	O	Makroekonomi	2	2	5
4	O	Bazat e Marketingut	2	2	5
5	O	Mjedisi Ndërkombëtar i Biznesit	3	2	5
6.1.	Z	Sjellja e Konsumatorit	2	2	4
6.2.	Z	Gjuhe Gjermane I	2	2	4
Gjithësej					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin njërin nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

#### Viti II - Semesteri III dhe IV

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Menaxhimi i Operacioneve	3	2	6
2	O	Menaxhimi i Projekteve	2	2	5
3	O	Informatika në Biznes	2	2	5
4	O	Anglishtja Afariste – II-	2	2	5
5	O	Kërkimet e tregut	2	2	5
6.1.	Z	Menaxhimi i Potencialëve Turistike	2	2	4
6.2.	Z	Zhvillimi në Karrierë	2	2	4
Gjithësej					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin njërin nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Financat Ndërkombëtare	2	2	5
2	O	Ndërmarrësi	2	2	5
3	O	E- Marketingu	2	2	5
4	O	Analiza Kuantitative në Biznes	3	2	6
5	O	Shkrim Akademik	2	2	5
6.1.	Z	Analiza Financiare	2	2	4
6.2.	Z	Gjuhë Turke	2	2	4
Gjithësej					<b>30</b>

Studentët duhet të zgjedhin njëren nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 4 kredi

### Viti III - Semestri V dhe VI

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Sistemi Informativ në Biznes	3	1	6
2	O	Qeverisja Korporative	3	1	6
3	O	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	2	1	5
4	O	Gjuhë Angleze III	1	2	5
5	O	Logjistika dhe Distribuimi	2	1	5
6.	O	Praktika			3
Gjithësej					<b>30</b>

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	Orë/Javë		ECTS
			L	U	
1	O	Marketingu Strategjik	2	1	4
2	O	Ligji i Kompanive	2	1	4
3	O	Biznesi Ndërkombëtar Projekt	0	3	4
4	O	Gjuhë Turke III	2	1	3
5	O	Vizita Studimore			3
6	O	PUNIMI I DIPLOMËS			12
Gjithësej					<b>30</b>



### 1.3 Administrim Biznesi (MSc)

Programi i studimeve në nivelin master “Administrim Biznesi” është program që ofron kualifikime postdiplomike në fushën e menaxhimit të biznesit. Ky program është i hartuar veçanërisht për studentët të cilët kanë përfunduar studimet themelore në fushën e biznesit dhe të cilët duan që të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë strategjike dhe planifikuese për t'i aplikuar ato në menaxhimin e bizneseve, jo vetëm në tregun e brendshëm por edhe në tregjet ndërkombëtare.

*Misioni i këtij programi të studimeve master ka për qëllim ofrimin e edukimit cilësor dhe ndërtimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve, zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave analitike të tyre për t'u përballur me sfidat e administrimit të biznesit në kushtet e një mjedisi ndërmarrës inovativ dhe konkurrues në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Të diplomuarit e këtij programi studimor do të kenë të zhvilluara shkathtësitë dhe kompetencat e tyre komplementare me kërkesat e tregut të punës, si dhe do të jenë të përgjegjshëm në ofrimin e kontributit të tyre në komunitet.*

Kurikula e programit master “Administrim Biznesi” i mundëson studentëve që të arrijnë njohuri për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e bizneseve në kontekstin lokal dhe ndërkombëtar, duke ofruar lëndë të përgjithshme nga fusha e analizave kuantitative, menaxhimit financiar, menaxhimit strategjik, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit të operacioneve, duke ofruar njohuri të specializuara përmes ofrimit të lëndëve zgjedhore dhe së fundi duke ofruar mësim nga përvoja përmes punimit të temës së diplomës master dhe hulumtimeve të zhvilluara së bashku me profesorët dhe punës në kompani.

Pjesë e rëndësishme e këtij programi studimor master është që të rrisë nivelin e hulumtimeve në fushën e biznesit. Është thelbësore që studentët të zhvillojnë aftësi analitike së bashku me aftësitë kreative, inovative dhe komunikuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme biznesore. Studentët i zhvillojnë aftësitë hulumtuese jo vetëm përmes lëndëve që ofron kurikula e këtij programi por edhe përmes bashkëpunimit me profesorë në projektet e ndryshme kërkimore dhe punës praktike në kompani. Për këtë qëllim, Instituti kërkimor-shkencor i themeluar brenda FE mundëson kushte më të mira për thellimin dhe avancimin e punës hulumtuese dhe të bashkëpunimit në mes të profesorëve dhe studentëve, si dhe profesorëve me profesorë të tjerë ndërkombëtar.

Njëkohësisht, ky program studimor ka si pjesë të rëndësishme të tij, kontributin në shoqëri duke ofruar një program cilësor që zhvillon njohuri të aplikueshme për tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe më gjerë duke zhvilluar aftësi hulumtuese të cilat do të ndihmonin bizneset, punonjësit dhe popullatën në përgjithësi të identifikonin dhe të zgjidhnin problemet e tyre. Për këtë qëllim është themeluar Bordi Këshillëdhënës Industrial (BKI) i cili ka për qëllim kontributin e BKI-së në hartimin e kurikulave mësimore duke u bazuar në nevojat e tregut të punës. Po ashtu, programi studimor ka paraparë edhe zhvillimin e vizitave studimore, nëpërmjet të cilave studentët do të kenë mundësi t'i përcjellin nga afër rrjedhat e menaxhimit, qeverisjes, financave etj, nëpër bizneset vendore e ndërkombëtare. Për këtë qëllim janë nënshkruar një varg i marrëveshjeve me akterë relevant të tregut. Lista e marrëveshjeve me partnerët e komunitetit të biznesit mund të gjendet në shtojcën e këtij raporti vetëvlerësues.

Objektivat e këtij programi janë që:

- studentëve të ju mundësoj të përvetsojnë njohuri teorike dhe praktike të qëndrueshme për organizatat biznesore,
- studentët të zhvillojnë aftësitë analitike për të kryer hulumtime dhe për të inkurajuar ide inovative,
- studentët të jenë të aftë dhe të shkathtë të menaxhojnë biznese të ndryshme,

- studentët të jenë në gjendje të zhvillojnë përshtatshmëri dhe fleksibilitet të qasjes dhe aftësisë për të inicuar dhe përgjigjur pozitivisht dhe në mënyrë të duhur ndryshimeve,
- t'i përgatisë studentët për karrierë në biznes ose për fushat që lidhen me biznesin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për të kontribuar në shoqëri,
- t'i rrisë aftësitë e të mësuarit të studentit gjatë gjithë jetës, aftësitë komunikuese dhe zhvillimin personal,
- studentët të jenë në gjendje t'i qasen drejtë zgjidhjes së problemeve me të cilat mund të ballafaqohen në garën biznesore,
- në fushëveprimin e këtij programi, studentët do të përfitojnë kompetenca shoqërore dhe ndërkulturore,
- studentët të përgaditen dhe të menaxhojnë suksesshëm me ndryshimet në korporata, si dhe të zhvillojnë dhe të praktikojnë nevojën e zbatimit të etikës biznesore dhe të përgjegjësisë sociale.

Rezultatet e pritura të të mësuarit:

Pas përfundimit të studimeve të programit studimor master “Administrim Biznesi”, studentët do të jenë të aftë:

- të hyjnë në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar të punës si të kualifikuar profesionalisht dhe me njohuri të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit;
- të veprojnë në mjedisin konkurrues të biznesit,
- të analizojnë nivelin strategjik, të zgjidhin probleme dhe të marrin vendime të përshtatshme në fushën shumë komplekse dhe të ndryshueshme të biznesit,
- të zbatojnë njohuritë e tyre në praktikë dhe t'i komunikojnë ato në audiencë të specializuar në mënyrë të qartë dhe bindëse,
- të përgatisin dhe prezantojnë teza dhe raporte sipas standardeve profesionale,
- të udhëheqin projekte investive,
- të organizojnë dhe zbatojnë projekte kërkimore,
- të menaxhojnë kohën në mënyrë efektive dhe në mënyrë të pavarur,
- të ketë një numër aftësish kompjuterike dhe komunikuese,
- të administrojë biznesin në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi sociale.

## Kurikula

### Mastër Shkencor në Administrim Biznesi - MSc

#### Viti I - Semester I and II, viti akademik 2021/2022

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS	Orë / Javë L	Orë / Javë U
1	O	Metodat e kërkimit shkencor	6	2	2
2	O	Sistemi informatik i menaxhmentit	6	2	2
3	O	Menaxhimi i financave të korporatave	7	3	2
4	O	Menaxhimi i marketingut	6	2	2
5.1	Z	Përgjegjësia sociale e bizneseve	5	2	1
5.2	Z	Integrimet ekonomike evropiane	5	2	1
<b>Σ</b>			<b>30</b>		
Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS	Orë / Javë L	Orë / Javë U
1	O	Ekonomiksi menaxherial	6	2	2
2	O	Ekonomiksi public	6	2	2

3	O	Qeverisja korporative	6	2	2
4	O	Kontabiliteti financiar i avancuar	7	3	2
5.1	Z	Aftësitë menaxheriale	5	2	1
5.2	Z	Menaxhimi i burimeve njerëzore	5	2	1
<b>Σ</b>			<b>30</b>		

### Viti II – Semeteri III and IV

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS	Orë / Javë L	Orë / Javë U
1	O	Menaxhimi strategjik	7	3	2
2	O	Biznesi Ndërkombëtar	6	2	2
3	O	Menaxhim operacionesh	5	2	2
4	O	Ekonometria	7	3	2
5.1.	Z	Kontabiliteti menaxherial i avancuar	5	2	1
5.2.	Z	E-Biznesi	5	2	1
<b>Σ</b>			<b>30</b>		
Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS		
1	O	Disertacioni	30		
<b>Σ</b>			<b>30</b>		

Studentët duhet të zgjedhin njëren nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 5 kredi

### 1.4 Kontabilitet dhe Auditim (MSc)

Programi i studimeve në nivelin master “Kontabilitet dhe Auditim” është zhvilluar në partneritet me praktikues kryesorë dhe me Asociacione profesionale. Programi ofron njohuri të thelluara të bazuara shkencërisht për të gjitha fushat e specializuara që janë të rëndësishme për fushën e kontabilitetit dhe auditimit, pa lënë pas dore rëndësinë praktike të përmbajtjes mësimore ose përgatitjen e kandidatëve për tregun e punës. Studentët që përfundojnë këto studime fitojnë ekspertizën për të zgjidhur problemet praktike mbi një bazë të shëndoshë shkencëre. Ky program është i hartuar veçanërisht për studentët të cilët kanë përfunduar studimet themelore në fushën e administrim biznesit dhe të cilët duan që të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë strategjike dhe planifikuese për t’i aplikuar ato në praktik, për menaxhimin financiar, qeverisjen korporative, raportimin financiar të bizneseve, jo vetëm në tregun e brendshëm por edhe në tregjet ndërkombëtare.

*Misioni i këtij programi të studimeve master ka për qëllim ofrimin e edukimit cilësor dhe ndërtimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve, zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave analitike të tyre për t’u përballur me sfidat e administrimit të biznesit në kushtet e një mjedisi ndërmarrës inovativ dhe konkurrues në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Të diplomuarit e këtij programi studimor do të kenë të zhvilluara shkathtësitë dhe kompetencat e tyre komplementare me kërkesat e tregut të punës, si dhe do të jenë të përgjegjshëm në ofrimin e kontributit të tyre në komunitet.*

Për shkak të natyrës specifike të programit, FE ka harmonizuar kurikulet e disa lëndëve si dhe syllabuset e tyre edhe me programin për çertifikim të kontabilistëve dhe auditorëve të cilën e ofron Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK), si pjesë e marrëveshjes mbi pranimin e ndërsjellë të provimeve, me ç’rast studentat tanë pas diplomimit në këtë nivel të studimeve pas-universitare, do të kenë mundësi të paisen edhe me Çertifikatën e Kontabilistit pas nënshtrimit të vetëm një provimi përmbledhës të cilin do ta

organizojë SCAAK. Me q'rast, studentat tanë do të kenë mundësi reale që të vijne shumë më shpejtë edhe tek vendi i punës në tregun e punës.

Pjesë e rëndësishme e këtij programi studimor master është që të rrisë nivelin e hulumtimeve në fushën e biznesit. Është thelbësore që studentët të zhvillojnë aftësi analitike së bashku me aftësitë kreative, inovative dhe komunikuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme biznesore. Studentët i zhvillojnë aftësitë hulumtuese jo vetëm përmes lëndëve që ofron kurikula e këtij programi por edhe përmes bashkëpunimit me profesorë në projektet e ndryshme kërkimore dhe punës praktike në kompani. Për këtë qëllim, Qendra për inovacion dhe punësim e themeluar brenda FE mundëson kushte më të mira për thellimin dhe avancimin e punës hulumtuese dhe të bashkëpunimit në mes të profesorëve dhe studentëve, si dhe profesorëve me profesorë të tjerë ndërkombëtar.

Njëkohësisht, ky program studimor ka si pjesë të rëndësishme të tij, kontributin në shoqëri duke ofruar një program cilësor që zhvillon njohuri të aplikueshme për tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe më gjerë duke zhvilluar aftësi hulumtuese të cilat do të ndihmonin bizneset, punonjësit dhe popullatën në përgjithësi të identifikonin dhe të zgjidhnin problemet e tyre. Për këtë qëllim është themeluar Bordi Këshillëdhënës Industrial (BKI) i cili ka për qëllim kontributin e BKI-së në hartimin e kurikulave mësimore duke u bazuar në nevojat e tregut të punës. Po ashtu, programi studimor ka paraparë edhe zhvillimin e vizitave studimore, nëpërmjet të cilave studentët do të kenë mundësi t'i përcjellin nga afër rrjedhat e menaxhimit, qeverisjes, financave etj, nëpër bizneset vendore e ndërkombëtare. Për këtë qëllim janë nënshkruar një varg i marrëveshjeve me akterë relevant të tregut. Lista e marrëveshjeve me partnerët e komunitetit të biznesit mund të gjendet në shtojcën e këtij raporti vetëvlerësues.

Objektivat e këtij programi janë që:

- studentëve të ju mundësoj të përvetsojnë njohuri teorike dhe praktike të qëndrueshme për funksionimin e organizatave biznesor,
- studentët të zhvillojnë aftësitë analitike për të kryer hulumtime dhe për të inkurajuar ide inovative,
- studentët të jenë të aftë dhe të shkathtë të menaxhojnë biznese të ndryshme,
- studentët të jenë në gjendje të zhvillojnë përshtatshmëri dhe fleksibilitet të qasjes dhe aftësisë për të inicuar dhe përgjigjur pozitivisht dhe në mënyrë të duhur ndryshimeve,
- t'i përgatisë studentët për karrierë në biznes ose për fushat që lidhen me biznesin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për të kontribuar në shoqëri,
- t'i rrisë aftësitë e të mësuarit të studentit gjatë gjithë jetës, aftësitë komunikuese dhe zhvillimin personal,
- studentët të jenë në gjendje t'i qasen drejtë zgjidhjes së problemeve me të cilat mund të ballafaqohen në garën biznesore,
- në fushëveprimin e këtij programi, studentët do të përfitojnë kompetenca shoqërore dhe ndërkulturore,
- studentët të përgaditen dhe të menaxhojnë suksesshëm me ndryshimet në korporata, si dhe të zhvillojnë dhe të praktikojnë nevojën e zbatimit të etikës biznesore dhe të përgjegjësisë sociale.

Rezultatet e pritura të të mësuarit:

Pas përfundimit të studimeve të programit studimor master "Kontabilitet dhe Auditim", studentët do të jenë të aftë:

- Për të hyrë në tregun e mbrendshëm dhe ndërkombëtar të punës si profesionistë të kualifikuar me njohuri të avancuara për kontabilitetin dhe auditim, qeverisje, tatime, raportim, analiza, etj.,

- të veprojnë në mjedisin konkurrues të biznesit,
- të analizojnë nivelin strategjik, të zgjidhin probleme dhe të marrin vendime të përshtatshme në fushën shumë komplekse dhe të ndryshueshme të biznesit,
- të aplikojnë njohuritë e tyre në praktikë dhe komunikojnë ato në formë të raporteve para drejtorave apo vendimmarrësve në mënyrë të qartë dhe të bindshme,
- të përgatisin dhe prezantojnë politika të kontabilitetit sipas standardeve profesionale,
- të propozojnë sistemin e kontrollit të brendshëm për kompanitë dhe organizatat e ndryshme
- të përgadisnin raporte financiare plotësisht në harmoni me Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar
- të udhëheqin projekte investive,
- të organizojnë dhe zbatojnë projekte kërkimore,
- të menaxhojnë kohën në mënyrë efektive dhe në mënyrë të pavarur,
- të zotërojnë një numër shkathtësish kompjuterike dhe komunikuese,
- të administrojnë biznesin në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi sociale.

## Kurikula

### Mastër Shkencor në Kontabilitet dhe Auditim - MSc

#### Viti II - Semester III and IV, viti akademik 2021/2022

Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS	Orë / Javë L	Orë / Javë U
1	O	Metodologjia e Kërkimit Shkencor	7	2	2
2	O	Analiza Financiare	6	3	2
3	O	Menaxhim Strategjik	6	2	2
4	O	SPSS/Anova	6	2	2
5.1.	Z	Biznesi Ndërkombëtar	5	2	2
5.2.	Z	Tatimet dhe Vendimarrja	5	2	2
<b>Σ</b>			<b>30</b>		
Nr.	O/Z	Lënda mësimore	ECTS		
1	O	Disertacioni	30		
<b>Σ</b>			<b>30</b>		

Studentët duhet të zgjedhin njërën nga lëndët zgjedhore e cila llogaritet 5 kredi